



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2021:045144

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05550749

P.nr.320/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me procesmbajtësen Hale Ahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurit A.D, për shkak të veprave penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), dhe veprës penale prezantimi i rrëm si person zyrtar nga neni 409 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.2023/19 e datës 09.03.2021, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar më datë **12.02.2024**, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ardiana Veseli dhe të pandehurit A.D se bashku më mbrojtësin e tij av.Fatmir Ademaj nga Peja, të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 08.03.2024, përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

A.D nga i ati R. e ëma Gj. e gjinisë T., i lindur me ... ne Pejë, me vendbanim në fshatin V. rr. “B.P” nr.41, Komuna I., gjithashtu me vendbanim edhe në shtetin e B. në qytetin T., i martuar, baba i katër fëmijëve, ka te kryer shkollën e mesme, i punësuar në shtetin e Belgjikës, i gjendjes se mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

1. Me parë e gjerë me datë 30.08.2019, rreth orës 13:00 në Bjeshkën e Vrellës në “Kodër të Dynës” Komuna Istog, i pandehuri në kundërshtim me nenin 5 par.1 të Ligjit për Armë (Ligji Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll një pushkë automatike me nr. Serik 9483-84, prodhim i panjohur, 4 (katër) gëzhoja prodhim të panjohur, 1 (një) karikator dhe 1 (një) pushkë pneumatike kal.6.35 mm, me nr. Serik 031904967, 1 (një) pako me 49 (katër dhjete e nëntë) diabola të kal.6.35mm, në atë mënyrë qe ditën kritike,

nga ana e policisë gjatë bastisjes në stanin e tij janë gjetur dhe sekuestruar armët e lartë cekura.

- me çka ka kryer veprën penale **mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.**
- 2. Më parë e gjerë me datë 30.08.2019, rreth orës 13:00 në Bjeshkët e Vrellës në “Kodër të Dynës” Komuna Istog, i pandehuri mban pa autorizim shenjën e personit zyrtar dhe prezantohet rrejtshëm si person zyrtar, në atë mënyrë që ditën kritike pasi që policia e Kosovës kanë shkuar në vendin e lartcekur, i njëjti ju prezantohet rrejtshëm si agjent i Interpolit duke prezantuar Emblemën e rrejtshme të INTERPOLIT me nr.7156.
- me çka ka kryer veprën penale **prezantimi i rrëm si person zyrtar nga neni 409 par. 1 të KPRK-së.**

Gjykata duke u bazuar në nenet e lartcekura të veprave penale dhe dispozitat e nenit 2, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 43, 44, 69, 76 të KPRK-së dhe nenet 242, 364, 459 të Kodit të Procedurës Penale (tutje KPP-së), të pandehurit i:

CAKTON

- Për veprën penale në pikën 1, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, i caktohet dënim me gjobë në shumën prej njëmijë e treqind (1300) euro.
- Për veprën penale në pikën 2, prezantimi i rrëm si person zyrtar nga neni 409 par.1 të KPRK-së, i caktohet dënim me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro.

Gjykata konform nenit 76 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM UNIK ME GJOBË

- I. Ashtu që, të pandehurit **A.D.**, i shqiptohet dënim unik me gjobë në shumë prej **njëmijë e pesëqind (1500) euro**, të cilin dënim me gjobë obligohet që ta paguaj në afat prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
 - Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron ta paguan dënimin me gjobë në afatin kohor të përcaktuar me lartë, atëherë dënimi më gjobë do të zëvendësohet më dënim me burgim, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, ku për çdo njëzet (20) euro të gjobës, do ti llogariten me një (1) ditë burgim, *përkatësisht 75 ditë burgim.*

- II. KONFISKOHEN:** një (1) pushkë automatike AK-47 me nr. Serik 9483-84, prodhim i panjohur; katër (4) gëzhoja te cal.7.65mm; një (1) karikator; një (1) pushkë pneumatike kal.6.35 mm, me nr. Serik 031904967; një (1) pako me dyzet e nëntë (49) diabola të kal.6.35mm; një emblemë e “INTERPOLIT” me nr.7156; një (1) shufër metali dhe një (1) radiolidhje. Të cilat kanë qenë të sekuestruar nga Stacioni Policor në Istog, numri i rastit 2019-DF-430. Dhe **URDHËROHET** që të gjitha këto, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të shkatërrohen nga Policia e Kosovës.
- III. OBLIGOHET** i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej **njëzet (20) euro**, ndërsa në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumë prej **njëzet (20) euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- IV.** Palë të dëmtuara nuk kishte.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës penale

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2023/19 të datës 09.03.2021, kundër të pandehurit A.D, për shkak të veprave penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale prezantimi i rrëm si person zyrtar nga neni 409 par.1 të KPRK-së.

Gjykata, pasi që është njoftuar nga Policia e Kosovës se e kanë arrestuar këtu të pandehurin sipas Letërrreshtimit vendor, të leshuar nga kjo gjykatë. Brenda afatit ligjor e ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 12.02.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Ardiana Veseli, i pandehuri A.D se bashku me mbrojtësin e tij av. Fatmir Ademaj, sipas autorizimit, ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjykata pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar akuzën, dhe pas njoftimit me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, i ka mundësuar të pandehurit të deklarohet për pranimin e fajësisë apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri A.D pas konsultimit me mbrojtësen e tij ka deklaruar: se e pranon fajësinë për shkak të veprave penale për të cilat akuzohet, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimit të fajësisë, pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se është penduar për këto veprime dhe i premtton gjykatës se ne të ardhmen do të këtë sjellje të mira dhe nuk do të kryej vepra penale.

Prokurori i Shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ka deklaruar: se pajtohet me pranimin e fajësisë, te deklaruar nga ana e të pandehurit për veprat penale për të cilat akuzohet, pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe ka mbështetje ne provat qe gjendet në shkresa të lëndës.

Mbrojtësi i të pandehurit A.D, av. Fatmir Ademaj, lidhur me pranimin e fajësisë nga i mbrojturi i tij, ka deklaruar: se pajtohem më pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të mbrojturit tim, i vije shumë keq për rastin që ka ndodhur dhe është pënduar thellë, dhe i premtos gjykatës që veprimet e tilla nuk do t'i përsërisë më në të ardhmen, po ashtu i njëjti është hera e parë që bije ndesh më ligjin, dhe për këtë ndjen keqardhje të madhe, po ashtu me rastin e shqiptimit të dënimit i propozoj gjykatës që në rastin konkretë ta aplikoj një gjobë ndaj të mbrojturit tim, por edhe të aplikimi i gjobës të ketë parasysh që i mbrojturi im është mbajtës i familjes dhe baba i katër fëmijëve.

Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Gjykata në rastin konkret lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pas marrjes së mendimeve të lartcekura, si dhe se pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 par. 1, par. 2 nën par. 2.1, 2.2 dhe 2.3, dhe par.3 të KPP-së, përkatësisht pas vlerësimit se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 242 par. 2, nën par. 2.4 të KPP-së, gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri për veprat penale të lartcekur për të cilat është akuzuar.

Vendimi për shpalljen fajtor

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të pandehurin t'a shpall fajtor për veprat penale për të cilat është akuzuar dhe e ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethanat të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurit, po ashtu në veprimet e tij manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprave penale të lartcekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas pranimin të fajësisë nga i pandehuri dhe konstatimit nga gjykata të përmbushjes së kushteve në referim të nenit 242 par. 1, 2 dhe 3 të KPP-së, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Rrethanat që janë marre për bazë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë dhe rrethanat personale se është pënduar dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale; ndërsa **rrethana rënduese** nuk ka gjetur. Andaj, Gjykata në rastin konkret nga rrethanat e lartcekura, ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është në proporcion me peshën e veprave penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e këtu të pandehurit, i cili do ta kuptojë rëndësinë e veprave penale të cilat i ka kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektojë që në të ardhmen mos të shkaktoj veprime të ndaluara- përkatësisht mos të kryej vepër penale, si dhe do të ndikojë tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale,

ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi unik me gjobë në shumën prej një mijë e pesëqind (1500) euro, i shqiptuar ndaj të pandehurit duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, me të cilin dënim do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Vendimi për konfiskim

Gjykata konform nenit 366 par.3 të KPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke konfiskuar armët dhe sendet tjera të specifikuara si më lartë, të përdorura nga i pandehuri në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm për armët dhe paautorizim.

Shpenzimet e procedurës

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 452 par. 1 dhe nenit 449 par. 2 të KPP-së, e ngarkoi të pandehurin me shpenzimet e procedurës të precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e po ashtu konform Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, e obligoi të paguaj shumën prej 20 euro në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit.

Gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara e në bazë të neneve 242, 364 dhe 369 të KPP-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

**Procesmbajtësja
Hale Ahmetaj**

**GJYQTARI
Petrit Nrecaj**

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovë në Prishtinë, *në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.*